



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LEGJISLATURA V
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor
Mbledhja nr. 52
Prishtinë, më 21.11.2016, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla S2

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Duda Balje, Adem Salihaj, Emilija Rexhepi, Shaip Muja, Time Kadrijaj, Murat Hoxha, Haxhi Shala dhe Salih Salihu.

Mungoi: Sergjan Popoviq.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Bajram Badivuku dhe Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi, **Duda Balje**, kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 14.11.2016;
3. Shqyrtimi i fidaneve të sëmura dhe të importuara nga jashtë;
4. Të ndryshme.

Kryesuesja **Duda Balje**, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të përcaktuar të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës për këtë mbledhje u miratua pa ndryshime, por **Time Kadrija** propozoi shtesë për shkak se sot ka përfunduar në komisionet e përhershme Projektligji për Obiliqin.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 14.11.2016

Procesverbali i mbledhjes, së mbajtur më 14.11.2016, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i fidaneve të sëmura të mjedrës

Duda Balje, kryetare, përshëndeti pjesëmarrësit në mbledhje: z. Shefki Zeqiri, drejtor në Departamentin Ligjor dhe z. Isuf Cikaqi, drejtor në Departamentin për Politika Bujqësore në MBPZHR, z. Valdet Gjinovci, kryeshef i Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë me bashkëpunëtorë, z. Avni Shabani, përfaqësues i Ndërmarrjes Agroprodukt Commerce sh.p.k. dhe fermerët, ndërsa shtoi se përfaqësuesi i USAID-it mungon, por sipas kontaktit me ta ata kanë përgatitur një raport me shkrim për këtë çështje.

Ajo ia dha fjalën **z. Adem Salihaj** me iniciativën e të cilit është caktuar kjo pikë e rendit të ditës. Ai fillimisht tha se ka kontaktuar dy fermerë që kanë paraqitur si problem çështjen e 440 mijë fidaneve të importuara nga firma Agroprodukt me seli në Peran të Komunës së Podujevës. Në dokumentet që ata i kanë sjellë është edhe një analizë e Institutit bujqësor të Kosovës, e porositur nga AUV-i që konstaton se fidanet e mjedrave janë të sëmura. Këto fidane janë shitur kryesisht në komunën e Podujevës dhe sipas pohimeve të fermerëve këto kanë rezultuar me dy lloje të sëmundjes: kanceri i bimës dhe këpudha që e thajnë fidanin. Kjo ka shkakuar një dëm për fermerët e kësaj komune. Pasi që këtu janë të gjitha palët e involvuara në këtë proces, qëllimi ynë, tha, është të dëgjojmë dhe të dimë se çka ka ndodhur: a janë importuar fidanet e sëmura, cili ka qenë roli i AUV-it dhe çka duhet të bëjmë për t'i sanuar problemet që janë krijuar.

Fermeri **Habib Mekolli** në emër të fermerëve tha se në fillim të gushtit e kemi vërejtur se nuk është diçka në rregull me mjedrat dhe filluam me verifikuar shkakun pse ka ardhur deri te kjo, kemi pasur një ekspert që i ka mbikëqyrë gjatë tërë vitit. Kemi komunikuar me kompaninë importuese dhe i kemi sqaruar se 35 – 45 % e fidanëve në pranverë kanë dështuar. Në pranverë kanë dalë kompania bashkë me USAID-in për numërimin dhe verifikimin e fidanëve të dështuara, dhe kanë premtuar se do të sjellin fidanët e reja. Në Drejtorinë për bujqësi në Podujevë kemi hasur në mirëkuptim dhe ata na kanë ndihmuar me i kërkuar AUV-it me dalë me verifikuar gjendjen e pemishteve në terren. Në shtator në disa pemishte i kanë marrë mostrat dhe sipas rezultateve dyshimet tona u vërtetuan dhe se një pjesë kanë dalë të sëmura me sëmundjen kërpudhore - *didymella applanata* dhe një pjesë me *agrobacterium tumefaciens* që është kancer i pemëve dhe sipas ekspertëve kjo e dëmton edhe tokën për disa vite. Kur i kemi marrë fidanët kompania në fjalë na ka dhënë një raport të një laboratorit privat në Prishtinë sipas të cilit fidanët janë në rregull dhe nuk janë me sëmundje, ndërsa i njëjti laborator pas një jave një fermeri nga Ferizaj për të njëjtat fidanë i kanë thënë se janë të sëmura dhe ia ka kthye, është fjala për 20 mijë

fidanë në vlerë 14 mijë euro. Ne kemi qenë fillestarë dhe kompania na ka premtuar se fidanët janë të klasës A të verifikuara dhe të certifikuara. Ne s'kemi pasur kontrata me kompaninë sepse na ka mjaftuar këshilla e USAID-it për orientim të kjo kompani, e cila ka qenë e vetmja importuese në këtë kohë.

Avni Shabani, përfaqësues i Ndërmarrjes Agroprodukt, tha se jemi kompania e parë dhe e vetme e licencuar prej kompanisë angleze, e cila e ka pasur të drejtën për tregtim të këtij materiali fidanor dhe çdo dërgesë dhe kërkesë e bërë në emër të Agroproduktit ka ardhur prej kompanisë angleze dhe asnjë fidan nuk ka hyrë në rrugë të tjera. Dërgesa apo materiali së pari ka hyrë në kufi, iu ka nënshtruar kontrolleve të përcaktuara me ligj, punëtorët fitosanitarë në kufi e bënë kontrollin dhe procesverbalin, pastaj inspektorët fitosanitarë i kanë marrë mostrat dhe i kanë dërguar në laborator dhe deri sa kanë ardhur analizat e inspektorëve fitosanitar ne s' kemi shpërndarë asnjë fidan. Pasi janë kthye të gjitha analizat dhe raportet dhe të cilat tregojnë se fidanët nuk janë të sëmura me përjashtim të didymellës dhe japin mendimin profesional se si duhet trajtohen dhe mund të mbillen. Ne, secilit fermer u kemi prezantuar me rastin e shitjes së fidanëve, u kemi dhënë edhe një kopje të analizave komplete. Pas daljes së problemit në terren të dështimit, ne kemi dalë me përfaqësuesit e USAID-it dhe në terren është konstatuar gjendja sa është numri i fidanëve të dështuara. Në bazë të këtij raporti i kemi shkruar kompanisë angleze dhe kompania na ka premtuar se numrin e fidanëve që kanë dështuar do t'ua kompensojë fermerëve.

Valdet Gjinoçci, kryeshf i AUV, rreth kompanisë në fjalë AUV-i tha se që nga fillimi ka bërë një kontrollim të rregullt sa i përket importit të fidanëve të mjedrës, dhe në kuadër të kësaj janë marrë mostra e janë dërguar në analiza. Prej mesit të vitit 2015 çdo maune blombohet dhe dërgohet në analiza laboratorike për verifikimin e gjendjes shëndetësore të fidanëve. Sa për ilustrim në vitin 2016 janë 104600 fidanë të asgjësuar. Lidhur me rastin në fjalë, fermerët në AUV që kanë kërkuar ndihmë bashkë me zyrtarët nga AUV-i kanë dalë në terren për verifikimin e këtij shqetësimi dhe janë njoftuar fermerët e rezultateve. Fidanët e mjedrës pas futjes brenda duan një trajtim specifikim edhe të ruajtjes, mirëpo janë edhe kushtet agroklimatike që ndikojnë.

Shefki Zeqiri, nga MBPZHR, mandati i ministrisë është hartimi i politikave dhe legjislacionit, si dhe zbatimi, prej vitit 2009 mbikëqyrja dhe kontrolli kanë kaluar në Zyrën e Kryeministrit. Sa i përket rastit konkret kompania është e licencuar në bazë të legjislacionit në fuqi në MBPZHR.

Isuf Cikaqi nga departamenti i bimëve në MBPZHR pohoi se kjo kompani sivjet është regjistruar në ministri dhe është licencuar bashkë me 55 të tjera, mirëpo ai potencoi IBK në Pejë për analiza e mostra në bazë të ligjit në fuqi nr. 2004/13 për materialin fidanor. Është me rëndësi shtoi ai, konstatimi se a kemi infektim të mëvonshëm apo ka ardhur me sëmundje fidani.

Adem Salihaj tha se ne dëgjuam se krejt gjërat kanë qenë në rregull dhe në anën tjetër fidanët janë të sëmura dhe se ky problem duhet të sqarohet, pastaj i shtroi këto pyetje për të ftuarit:

- Për fermerët; A është e saktë se të gjitha këto fidanë të importuara nga firma Agrokomerc janë të sëmura, çka ka ndodhur këtu kur krejt analizat tregojnë se kanë qenë në rregull?
- Për pronarin e Agroproduktit; A është e saktë se fermeri nga Ferizaj i ka kthye fidanët për arsyen se janë të sëmura?

- Për AUV-in, Ne s'po e kuptojmë se si, në pikën kufitare ku janë marrë mostrat e fidanëve keni konstatuar se janë 100% në rregull, kurse tash nga pemët analizat tregojnë se 100% nuk janë në rregull, kjo është një situatë kundërthënëse, si e shpjegoni këtë?

Fermeri **Habib Mekolli**, në bazë të AUV-it që kanë marrë mostrat në 10 raste (ndërhyri Ismet Fejzullahu nga AUV, këtu është fjala për prodhim e jo për fidanë, ndërsa Isuf Cikaqi bëri një sqarim se në momentin kur është në pemishte ai nuk është fidan më, por është pemë). Fermeri përsëriti rastin e fermerit nga Ferizaj në lidhje me analizat dhe kjo dëshmon se ato nuk janë infektuar prej tokës, por kanë ardhur të infektuara. Ndërsa mostrat që kanë marrë AUV-i në pemë zakonisht i kanë marrë 2-4 mostra prej një parcele në rreth 10 parcela dhe të gjitha s'kanë qenë të shëndosha.

Avni Shabani, nga Agroprodukti, tha se fermeri në fjalë i ka bërë analizat, po çfarë fidanësh ai ka dërguar për analiza mbetet në ndërgjegjen e tij, ndërsa ne si kompani për çdo fermer i cili ka pasur dyshime nuk kanë pasur obligim me marrë materialin fidanor dhe ju kemi kthye mjetet. Fermeri nga Ferizaj ka pasur dyshimet e veta dhe ne ia kemi kthye mjetet dhe atë material fidanor nuk e kemi shitur më tutje.

Valdet Gjinovci: Pasaportë e futjes së fidanit është certifikata fitosanitare e fidanit e cila garanton për produktin, mirëpo edhe te rastet e marrjes së mostrave në terren, raporti i laboratorit thotë: mostra e analizuar e fidanit të mjedrës është e infektuar nga *didimella* dhe fidanët e infektuara me këtë patogjen mund të mbillen nëse përkujdesemi për to dhe atë me krasitje që duhet të bëhet në pjesët e infektuara dhe gjatë vegjetacionit të bëhet spërkatja me fungicide. Fidanët që janë importuar i kanë plotësuar kushtet dhe që e dokumenton certifikata fitosanitare për gjendjen shëndetësore të saj. Ekspertët e fushës ndoshta mund të japin sqarim se cilët kanë qenë faktorët apo shakatarët që ka ardhur deri te infektimi, këtu janë edhe kushtet e tjera klimatike e ambientale që ndikojnë në gjendjen shëndetësore të fidanëve në këtë rast.

Adem Salihaj potencoi faktin se nuk kupton faktin si është e mundur që kanë hyrë të shëndosha, pastaj të rezultojnë të sëmura këto fidanë.

Edhe **Salih Salihu**, potencoi se është e saktë se ka fidanë të infektuara që janë importuar, ndoshta edhe importuesi nuk e di që kanë qenë të infektuara sepse ky e merr certifikatën fitosanitare nga vendi i origjinës. Për sëmundjen *didimella* nuk është ndonjë problem, ajo është shëruese, ndërsa *agrobacteriumi* është problem dhe nuk shërohet. Në lidhje me këtë ne kemi dështuar si institucion për me vërtetuar në kufi me kohë në qoftë se bimët kanë qenë të sëmura. Pastaj në sipërfaqet e mbjella ka sipërfaqe të infektuara me *agrobacterium*, prandaj fermerët janë djegur dhe ne duhet me përcaktuar se kush është përgjegjës: kompania importuese apo institucioni që nuk ka mundur me bërë kontrollin e materialit që ka hyrë në kufi, por jo fermeri sepse ai ka paguar për këtë dhe si institucione duhet me gjetur mënyrën se si me i kompensuar për dëmet.

Fermeri Nexhat Pllana, shtoi se secilit fermer i ka kushtuar investimi prej 15-20 mijë euro për një hektar, 50 ari më ka kushtuar 7500 euro dhe tash paguaj 200 euro në muaj kreditin që kam marrë prej 5000 eurosh. Kam shpresuar me zhvilluar familjen me këtë, sot s'di çka me bërë.

Shaip Muja, diskutimin e filloi me pyetjen për fermerët se sa janë të edukuar, apo trajnuar për këtë veprimtari dhe mori përgjigjen se ata nuk janë të shkolluar për këtë, por janë trajnuar nga USAID-i për këtë. Problemi që ka ndodhur në terren është fakt se këto fidanë janë të dëmshme dhe duhet me sqarua ka ndodhur infeksioni brenda Kosovës apo

është i importuar? dhe shteti e ka përgjegjësinë për fermerët, në lidhje me donacionet që u jep dhe edukimin. Vullneti i juaj ka qenë shumë pozitiv, por edukimi ka qenë jo i mjaftueshëm dhe se pa edukimin bazë të fermerëve nuk duhet t'u jepen donacionet sepse nuk mundën me i mbërrirë rendimentet e duhura. Ndërsa nga aspekti ligjor tha se faji është të deputetët, në miratojmë ligje dhe nuk monitorojmë donacionet që i ndan ministria. Reagoi **Salih Salihu** dhe **kryetarja** shtoi se USAID i ka kryer të gjitha trajnimet e duhura, nuk është e mundur që nga 90 fermerë nuk ka pasur asnjë të edukuar (të trajnuar), insistoi se sëmundja ka ardhur nga fidanët e importuara, ngase bakterja në fjalë jeton vetëm te mjedra, si dhe fakti që toka jonë nuk e ka këtë bakterje.

Shaip Muja shtoi në reagimin e tij se USAID-i bënë edukime fiktive dhe përmendi si qendër të edukimit më të mirë inkubatorin në Lipjan, kurse sa i përket shkollimit, te ne, kemi më tepër diploma se dijeni. Sa i përket këtij rasti duhet të kërkohet që nëse mundet MBPZHR-a me i gjetur fondet me financuar për financimet e ardhshme që planifikohen për vitin 2017.

Time Kadrijaj konstatoi edhe një herë se të ftuarit sot nuk janë këtu për t'i akuzuar, por për të kontribuar për një konkluzion të përbashkët, kurse rasti do të zgjidhej sipas saj nëse MBPZHR dhe AUV bashkëpunojnë për gjetjen e zgjidhjes dhe mos të dëmtohen fermerët. Në të ardhmen të jenë më të kujdesshëm që të dihet se nga po vjen kjo sëmundje dhe rastet e tilla mos të na përsëriten.

Kryesuesja i pyeti përfaqësuesit e ministrisë, sa ka bazë ligjore për kompensimin e fermerëve.

Shefki Zeqiri tha se kompetencat e ministrisë është licencimi ose heqja e licencës nëse konsiderohet se ka bë shkelje ligjore, sa i përket kompensimit nuk ka ligj as fond të veçantë për kompensime dhe këtu kemi të bëjmë me marrëdhënie kontraktuale mes fermerit dhe kompanisë.

Emilija Rexhepi ishte e mendimit se ky rast mund të dërgohet në gjykatë ngase elementet janë që duhet vërtetuar fajësinë, më saktë dhe ka shkelje ligjore.

Adem Salihaj në përmbyllje tha se konsideroj se sot nuk kemi arritur ta sqarojmë problemin, sepse dy çështje që u shtruan kërkojnë sqarim të mëtutjeshëm. Së pari edukimi i fermerëve nuk mund të jetë i mangët vetëm për këto fidanë që janë blerë nga Agroprodukti pasi që një pjesë e madhe e këtyre fermerëve e kultivojnë mjedren edhe më herët dhe kanë pasur sukses. Te AUV-i është një çështje që kërkon sqarim, si është e mundur që analizat e mostrave të fidanëve 100% kanë dalë në rregull, kurse analizat nga pemët tregojnë se 100% nuk janë në rregull. Ne, si Komision, do ta trajtojmë këtë çështje edhe më tutje dhe do të mundohemi me gjetur ku është problemi, është te fermerët, te importuesi apo te AUV-i, si dhe do të propozojmë një zgjidhje për këtë problem, sepse interesi ynë është me i mbrojtur fermerët dhe qytetarët tanë.

5. Të ndryshme

Kryesuesja konstatoi se **Projektligji për Zonën e Rrezikuar Mjedisore të Obiliqit dhe rreth tij** është shqyrtuar nga komisionet e përhershme dhe mund të procedohet në leximin e dytë mbledhjes plenare, pasi që komisioni nuk ka vërejtje shtesë.

Mbledhja përfundoi në orën 13:05.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Duda Balje